

# Informacion mbi ligjin për qëndrimin në shtëpitë e përkujdesjes

E drejta themelore për lirinë e lëvizjes është një e drejtë e njeriut. Në Austri është përmes ligjit për "Mbrojtjen e lirisë personale" pjesë e kushtetutës federale. Kufizimet të kësaj të drejte themelore janë të mundura vetëm mbi bazën e dispozitave ligjore.

Për **Institucionet e fëmijëve dhe të rinjve si dhe për zonën e veçantë të shkollës dhe kopshte** Ligji për qëndrimin në shtëpitë e përkujdesjes rregullon se mbi çfarë kushtesh lejohet kufizimi i të drejtës së lirisë së lëvizjes.

## **Kufizimi i lirisë**

Nëse një personi nën kujdestari ose përkujdesje i ndalohet ndryshimi i vendit kundër ose pa vullnetin e tij, kjo përkufizohet si kufizim i lirisë. Për këtë përdoren mjete mekanike, elektronike ose medikamentoze.

Për të përmbushur kushtet ligjore për një masë të tillë, personi në fjalë duhet të jetë një person me sëmundje fizike ose kufizim intelektual. Duhet të ketë një rrezik të rëndë dhe të lartë për të prekurin vetë ose për mjedisin e tij. Masa e kufizimit të lirisë duhet të jetë në proporcion me rrezikun. Kjo do të thotë se ajo duhet të jetë e arsyeshme dhe absolutisht e domosdoshme. Në çdo rast, më përpara duhet të provohen alternativa. Kufizimi i lirisë duhet të jetë gjithmonë vetëm mjete i fundit i zgjedhjes.

Kufizimet e të miturve, të cilat janë tipike për moshën, nuk janë kufizime të lirisë në kuptimin e ligjit për qëndrimin në shtëpitë e përkujdesjes. Kjo është për shembull lidhje me rrip e një fëmije të vogël në karrocën e fëmijëve.

Për të vlerësuar nëse bëhet fjalë për një masë tipike për moshën nuk ka kritere përgjithësisht të zbatueshme. Duhet të vendoset për rastin individual. Në rast dyshimi këshillohet një njoftim i përfaqësimit të banorëve.

Drejtuesi pedagogjik duhet të urdhërojë çfarëdo kufizim të lirisë dhe të sqarojë personin e prekur lidhur me këtë. Kjo do të thotë që fëmijët dhe të rinjtë e prekur duhet të informohen mbi arsyen, llojin dhe kohëzgjatjen. Kjo duhet të shënohet edhe në dokumentacion.

Në vijim është i nevojshëm një njoftim i përfaqësimit të banorëve. Masat e kufizimit të lirisë duhet të kontrollohen rregullisht nëse ato janë ende të nevojshme. Nëse ato zbatohen më gjatë se 48 orë, duhet të merret një dokument mjekësor.

### **Përfaqësimi i banorëve**

Përfaqësimi i banorëve kontrollon direkt në vend nëse kufizimet e lirisë janë të nevojshme dhe të arsyeshme. Për këtë ai flet me fëmijën/të riun e prekur, personelin dhe administratën e institucionit. Ai shikon dokumentacionin dhe dokumentet mjekësore.

Përfaqësimi i banorëve ose administrata e institucionit mund të kërkojnë një kontroll të masave të kufizimit të lirisë pranë Gjykatës së Qarkut. Në këtë mënyrë ruhet një standard minimal i të drejtave të njeriut, mbi bazën e të cilit çdo person, liria e të cilit kufizohet, ka të drejtën për një proces para një gjykate të pavarur. Ajo vendos nëse kufizimi i lirisë është i lejuar.

### **Trajnimet**

Përfaqësimi i banorëve ofron gjithashtu trajnime për zbatimin e ligjit për qëndrimin në shtëpitë e përkujdesjes. Në rast interesit, në kontaktoni:

[bewohnervertretung@vertretungsnetz.at](mailto:bewohnervertretung@vertretungsnetz.at)

